



# BACHELOR EKONOMIKS

NË BASHKËPUNIM ME UNIVERSITETIN BOKU

# Pse ky program studimi?

Programi Bachelor në Ekonomiks, në bashkëpunim me **Universitetin BOKU**, është ndërtuar si një program me orientim analitik, i cili i përgjigjet nevojave të tregut të punës në sektorin ekonomik, bujqësor dhe agroushqimor, si dhe në zhvillimin e territorit dhe komuniteteve rurale.

Programi ofron një formim të integruar teorik dhe praktik, me një profil të fokusuar në ekonominë e aplikuar, duke u përqendruar në kuptimin e sfidave të zhvillimit ekonomik, hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm, analizimin e tregjeve ekonomisë bujqësore etj


Me një kurrikulë të harmonizuar me standardet europiane, programi forcon lidhjen mes arsimit të lartë dhe tregut të punës, duke përgatitur studentët për karrierë në sektorin publik, privat, OJQ dhe agjenci zhvillimore, si dhe për zbatimin e politikave europiane për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

**Diplomë që njihet ndërkombëtarisht**



## Përshkrimi i programit

Programi Bachelor në Ekonomiks ofron një formim të integruar teorik dhe praktik në shkencat ekonomike, me fokus të veçantë në bujqësi, zhvillim rural dhe ekonomi të qëndrueshme. Ai ndërtohet mbi parimin e ndërdisiplinartetit, duke kombinuar ekonominë, shkencat sociale, teknologjinë dhe shkencat natyrore. Programi zhvillohet në tre vite studimi (180 ECTS) dhe ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural. Studentët përgatiten për analiza ekonomike, politikëbërje dhe vendimmarrje në sektorë publikë dhe privatë.



# Profili i të diplomuarit / Profil profesional

Të diplomuarit në Ekonomiks formohen si profesionistë me aftësi analitike, ndërdisiplinare dhe praktike. Ata mund të ushtrojnë profesionin si:

1. **Ekonomist zhvillimi**, i angazhuar në analiza dhe politika zhvillimore;
2. **Analist ekonomik/politikash**, në institucione publike dhe agjenci zhvillimore;
3. **Specialist i ekonomiks të aplikuar**, në sektorin privat, financa apo konsulencë;
4. **Ekspert projektsh zhvillimi**, në organizata kombëtare dhe ndërkombëtare



## Klaudia Vukzaj

Drejtorja e Përgjithshme e  
Taksës së Pasurisë, MF

“Kam studiuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe e rekomandoj sepse ofron një kombinim të fortë teorik dhe praktik, programe të orientuara drejt tregut të punës, staf të përkushtuar dhe mundësi reale për zhvillim profesional.”



## Sara Mira

Ekonomiste, AMG shpk

“Studimet në Ekonomiks të Aplikuar në UBT më dhanë njohuri të thelluara mbi funksionimin e sistemeve ekonomike dhe aftësi analitike, të cilat prej tre vitesh i zbatoj si ekonomiste në sektorin privat, duke zhvilluar kompetenca të qëndrueshme dhe duke ndërtuar një profil profesional të suksesshëm.”



## Alba Tema

Menaxhere Projektsh, Rrjeti  
Shqiptar për Zhvillimin Rural

“Studimet në Ekonomiks të Aplikuar më dhanë aftësi analitike për të vlerësuar politikat publike në bujqësi dhe zhvillim rural, duke lidhur teorinë me realitetin e komuniteteve dhe mbështetur vendimmarrjen me evidenca.”



## Saimir Tollia

Doktorant IAMM Montpellier

“Studimet në Master MIDAS dhe doktoratura në IAMM Montpellier më kanë dhënë njohuri të avancuara në ekonominë bujqësore dhe politikat rurale, duke më aftësuar të analizoj ndikimet e politikave subvencionuese mbi fermat, tokën dhe punësimin, dhe të mbështes vendimmarrjen me evidenca shkencore.”

# Kompetencat kryesore të fituara

Në përfundim të programit, studentët fitojnë kompetenca në:

- Analizimin dhe interpretimin në mënyrë kritike të teorive kryesore të ekonomisë dhe ndikimin e tyre në zhvillimin ekonomik.
- Vlerësimin e politikave publike dhe përdorimin e të dhënave dhe mjeteve digjitale për vendimmarrje të informuar.
- Aplikimin e metodave sasiore dhe cilësore për analizën e fenomeneve ekonomike në nivel mikro dhe makro.
- Hartimin e strategjive të zhvillimit dhe analizën e sektorëve bujqësorë, ruralë dhe mjedisorë.

Këto aftësi janë të përshtatura me nevojat aktuale dhe afatgjata të tregut të punës.

## PËRMBAJTJA E STUDIMEVE

### LËNDËT BAZË

Bazat e ekonomisë,  
Bazat e matematikës,  
Bazat e statistikës,  
Mikro dhe Makroekonomi,  
Lëndë ndërdisiplinore

### LËNDËT KARAKTERIZUESE

Analiza më të avancuara  
ekonomike, Politika  
ekonomike dhe zhvillim  
rural, përfshirë temat e  
ndryshimeve klimatike dhe  
bujqësisë inteligjente

### TË TJERA

Bujqësi precize,  
Automatizim,  
Aplikime mjedisore,  
Praktikë profesionale dhe  
punim diplome

Mësimdhënia realizohet përmes leksioneve interaktive, seminareve, ushtrimeve praktike dhe punës laboratorike. Programi përfshin punë laboratorike të strukturuar, projekte studimore dhe praktikë profesionale të detyrueshme.

## Mundësi Punësimi:

- Punësim në institucione publike qendrore dhe vendore, përfshirë ministri, bashki dhe agjenci zhvillimi
- Pozicione në organizata ndërkombëtare dhe OJF
- Mundësi në sektorin privat, institucione financiare dhe kompani konsulence
- Kërkesë e lartë për ekonomistë me kompetenca të specializuara në sektorin agroushqimor, zhvillimin rural, politikat publike dhe integrimin europian.

# Të dhënat e programit

## Niveli i studimit

Cikli i parë, Bachelor

## Titulli akademik

Bachelor në Ekonomiks

## Kohëzgjatja

3 vite akademike / 6 semestra

## Kredite

180 ECTS

## Forma e studimit

Me kohë të plotë

## Gjuha e studimit

Shqip / Anglisht

## Kuota studimi

126 studentë

## Përfundimi i studimeve

Provim formimi / Temë diplome



# Rreth UBT

Universiteti Bujqësor i Tiranës u themelua më 1 nëntor 1951 dhe prej vitit 1956 është vendosur në Kodër Kamëz. Që nga krijimi, ai ka qenë një shtyllë e arsimit dhe kërkimit bujqësor në Shqipëri.

Sot, UBT luan një rol kyç në bujqësinë e qëndrueshme, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar përmes partneriteteve strategjike, përfshirë Universitetin BOKU të Vjenës.



## Për më shumë informacion vizitoni:

[www.ubt.edu.al](http://www.ubt.edu.al)

[info@ubt.edu.al](mailto:info@ubt.edu.al)

Rruga "Pajsi Vodica" Tiranë

## MUNDËSI VAZHDIMI STUDIMESH (MASTER)

Pas diplomimit, studentët kanë mundësi të vazhdojnë studime të ciklit të dytë (Master) në Ekonomi Qarkulluese, Politika Publike, Zhvillim Rural, Agrobiznes, Financa ose fusha të afërta, brenda dhe jashtë vendit. Programi siguron një bazë të fortë teorike dhe metodologjike për vazhdimësi akademike.

## FOLLOW US ON SOCIAL MEDIA



Agricultural University of Tirana



universiteti\_bujqesor\_tiranes  
fea\_ubt



Universiteti Bujqësor i Tiranës - Faqja Zyrtare  
Fakulteti i Ekonomise dhe Agrobiznesit - UBT- faqja zyrtare

*Për jetën dhe të ardhmen...*